

**AGRON GJEKMARKAJ****MBI VEÇANTITË DHE ETAPAT E MENDIMIT KRITIK  
PËR VEPRËN E AT ZEF PLLUMIT**

I ardhur nga burgjet komuniste At Zef Pllumi do të shfaqej publikisht para besimtarëve e qytetarëve të Tiranës natën e Krishtlindjeve me 24 dhjetor të vitit 1990. Ishte mesha e parë në Kryeqytet që pas mbylljes së objekteve të kultit në vitin 1967. Prania e këtij prifti katolik në Tiranë ishte sinjal lirie. Do të meshonte në pragun e Kishës Françeskane, dera e së cilës ishte e kyçur me dryn, por Shën Françesku ishte ngulur në gjoksin e tij përjetësisht, bashkë me kryqin në pagëzim dhe, për doktrinën e tij *pax et bonum*, nuk duhej çelës. Shqipëria zyrtarisht ishte akoma një vend ateist. Predikimi i tij para shumë njerëzve të besimeve të ndryshme që kishin sfiduar pengesat e sigurimit të shtetit është edhe zanafilla e mendimit të tij publik, “guri i themelit” i fenomenit Pllumi. Do të fliste atë natë për Zotin dhe dashurinë, por edhe për Faljen si instrument i Hyjit. Qindra vetë, në shumicë të besimit Islam, dëgjonin të përbotur këtë veteran të burgjeve të komunizmit që ju fliste për dashurinë, kundër dhunës, për lirinë, kundër tiranisë.

Ndërsa për të parën herë në një sallë zyrtare të shtetit shqiptar do të hynte me 28 dhjetor të vitit 1990, pikërisht në takimin e parë për kujtimor të organizuar për Fishtën qysh nga gjysma e viteve ‘40. Diçka jo e zakonit kishte ngjarë, aty ku ishin ekzekutuar vendimet që Fishta të dilte nga historia e letërsisë, pikërisht në Lidhjen e Shkrimtarëve. Në një shpallje të varur në murin e saj të jashtëm këto vendime nënshkruheshin me formulën gjoja demokratike “*një grup dashamirës*<sup>1</sup>” të poetit. Frati ishte i ulur diku në mes të dëgjuesve ende me veshjen e burgut të fundit.

Ashtu siç e përshkruan një njohës i mirë i tij, “*me energjinë e një njeriu që sapo e kishte filluar jetën*<sup>2</sup>”, fillon misionin si njeri i fjalës dhe i kulturës,

<sup>1</sup> At Zef Pllumi, “Francheskanët e Mëdhaj” në *Histori kurrë e shkrueme*, Botimet “55”, Tiranë 2006, f. 142.

<sup>2</sup> M. Marku, “At Zef Pllumi i fundmi i françeskanëve të mëdhenj”, *Gazeta Panorama*. Tiranë, 27 Shtator 2007.

për t'u bërë një nga rrëfimtaret më unikalë të historisë sonë dhe një nga lëvruetit më të shquar të gjuhës shqipe. Shenjat e këtij misioni i gjejmë qysh tek intervista e tij e parë që daton më 19 korrik 1992 tek gazeta "Drita". Aty ai jep disa shpjegime themelore nga njohja e të cilave, duke i gjykuar nga distanca historike, kuptojmë që në atë kohë ai po përcaktonte objektivat kryesore në fushën e memuaristikës, të letërsisë e të kulturës shqiptare në tërësi.

Këto objektiva burojnë nga normat dhe kërkesat e Urdhrit Françeskan me moton e tij "*Atme e fe*", nga trashëgimia e françeskanëve të mëdhenj shqiptarë si At De Martino, At Gj. Fishta, At Sh. Gjeçovi, At A. Harapi, At L. Shllaku, At V. Prendushi etj., themelues të një sistemi kulturor dhe të një tradite nga më të shkëlqyerat që ka njohur historia e kulturës sonë. Këta "*punuen pa u lodhë me një program të caktuem për formimin e një kulture me individualitet të veçantë kombëtar shqiptar, rikthimi i kësaj tradite si model shqiptar dhe europian njekohësisht*"<sup>3</sup>. Rrëfimi i historisë së vërtetë të dekadave të regjimit komunist është amaneti që i është lënë që në ditët e para të vendosjes së diktaturës nga At Marin Sirdani, i cili e urdhëron "*Rrno vetëm për me tregue*", amanet që ai do ta jetësojë në veprën e tij madhore "*Rrno vetëm për me tregue*".

Personaliteti i individit i dëmtuar rëndë nën komunizëm, raporti i tij me lirinë dhe tiraninë janë temat e tij të parapëlqyera. Të fortë e ka dëshirën e po ashtu edhe përpjekjen për të ushqyer edukatën dhe kulturën demokratike e kombëtare kundër një edukate e kulture antidemokratike e antikombëtare. Qysh në fillim të viteve '90 At Zef Pllumi do të afirmohej si një personalitet ndryshe i kulturës shqiptare jo thjesht si i fundit i françeskanëve të mëdhenj, por si një intelektual, shkrimtar dhe mendimtar i një lloji tjetër, i cili, me veprën që do të publikonte do të trazonte shumë ujëra në historiografinë shqiptare si dhe në letërsinë tonë, duke krijuar antimodelin e realizmit socialist. Në vitin 1993 ai rithemelon revistën e njohur e prestigjioze të themeluar nga At Gjergj Fishta në vitin 1913 "Hylli i Dritës", duke mbledhur rreth vetes, "rreth votrës së kulturës" një çetë intelektualësh shqiptarë, të cilët "nuk dëshirojshin me ndeje ndër kioska tu pi kafe e tuj ba llafe por që dojshin me kontribu me i dhanë vendin që i takon kulturës së vërtetë shqiptare"<sup>4</sup>.

<sup>3</sup> Intervistë dhënë Gazetës *Drita*. Tiranë, 19 Korrik 1992.

<sup>4</sup> At Zef Pllumi, intervistë në TVSH me gazetaren Arjana Qatipi. Prill 1995. f. 12.

Në këtë revistë shfaqen shenjat e para të kujtimeve të tij të mëvonshme të cilat, pas botimit të tyre do të rritin ndjeshëm e pareshtur ndikimin kulturor e publik.

Marsi i vitit 1995 shënon edhe daljen e vëllimit të parë të trilogjisë “*Rrno vetëm për me tregue*”<sup>5</sup>, moment ky që nxit fillimin e formësimit të mendimit kritik për veprën e tij. Kjo fillesë është parathënia e shkruar nga Aurel Plasari, e cila rrëfen se, për të kuptuar përse i shkruan ai kujtimet, do të na duhej të njihnim gjithësesi personalitetin e tij. Plasari e ka pasur këtë mundësi dhe e gjen të udhës të shpjegojë për të tjerët se me Pllumin e saponjohur në fundin e ‘90-s “kuvendimet kishin të bënin pak me revelatën, ascezen, pentekosten epifaninë, katekizmin dhe konvertimin: “*Mund të kuvendoje me të asokohe për të drejtat e njeriut, liritë e mendimit dhe të besimit, për botime librash dhe revistash, për organizime institucionesh dhe revistash, për organizime institucionesh demokratike sipas modelit perëndimor, për ringjallje traditash, lidhje venash të prera të kulturës shqiptare: një ndryshim hipostazash*”<sup>6</sup>. Qasja e tij është bërë në një këndvështrim sociologjik duke pasur parasysh edhe kohën kur këto ishin çështjet kryesore që shqetësonin botën shqiptare, duke i atribuuar Pllumit nëpërmjet temave të cituara më sipër, si rolin e misionarit për shumëçka, apo të mendimtarit të një lloji tjetër, ashtu edhe atë të shkrimtarit të mirëfilltë. Në parathënien e tij të parë Plasari nuk zbret tek teksti, por mbetet tek konteksti. Kontekst i mbështjellë me një gjykim referencial edhe për më vonë, sepse “*Rrno vetëm me tregue*” është një libër kujtimesh i cili bën thirrje që të vërtetat të mos harrohen, që historia të mos shformohet, por të kuptohet dhe të shpjegohet, është kontribut në luftën e një populli për demokracinë”<sup>7</sup>. Në përgjithësi dalja e këtij libri u shoqërua me mjaft shkrime dhe komente në organet e shtypit të cilat (përfshi edhe autorin e këtyre radhëve) ndaleshin kryesisht tek ajo çka frati rrëfente dhe jo se si ai rrëfente, pra interpretimet ishin të këndvështrimit sociologjik e utilitar, në sintoni me gjuhën politike të ditës.

E njëjta dukuri ndodhi me vëllimin e dytë “*Liria midis dy burgjeve*”<sup>8</sup> e botuar në vitin 1997 dhe atë të tretin “*Robnia e gjatë*”<sup>9</sup> në vitin 2001. Në

<sup>5</sup> At Zef Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*. Botues Hylli i Dritës. Tiranë, 1995.

<sup>6</sup> Ibidem f. 4.

<sup>7</sup> A. Plasari, Parathënie *Rrno vetëm për me tregue*, Botues “Hylli i Dritës”. Tiranë, 1994, f. 3.

<sup>8</sup> Vëllimi i dytë i trilogjisë *Rrno vetëm për me tregue*, Botues Hylli i Dritës. Tiranë, 1997.

ribotimin e vitit 2005 tashmë të tre librat e mëparshëm do të bashkoheshin në një vëllim të vetëm<sup>10</sup> duke i shtuar edhe një parathënie që do të shkruhej nga shkrimtari Ismail Kadare, i cili, ashtu si Plasari, pëlqen që t'i qaset veprës së ribotuar duke e vendosur në një kontekst të gjerë moral dhe duke e vlerësuar atë veçanërisht nga pikëpamja e dobishmërisë së madhe shoqërore që ky libër ka për shoqërinë shqiptare e më gjerë, madje për krejt ish-perandorinë komuniste. Por tashmë kishin kaluar dhjetë vjet nga dalja e librit të parë, i cili në fillim i kishte dhënë statusin e dëshmitarit të veçantë. Tani Kadare shton se “*At Zef Pllumi, shkrimtar, publicist e memorialist i shquar ... ishte aty për të dëshmuar*” duke pohuar se kjo është një dëshmi nëpërmjet letërsisë për të cilën “*Kanë nevojë për të ata që e kanë jetuar atë kohë, e po aq, në mos më tepër, ata që nuk e kanë jetuar. Kanë nevojë të shtypurit e të nëpërkëmburit, e po aq, në mos më tepër, ata që shtypën të tjerët, kanë nevojë antikomunistët, e po aq, ndoshta më tepër, komunistët. Shkurt për të ka nevojë ndërgjegjja jonë*”.<sup>11</sup>

Shkrimtari Kadare e sheh këtë libër si fuqi e akt moral dhe, njëkohësisht, si një mision të madh përpara historisë dhe ndërgjegjes shqiptare. Për një dekadë Atë Zef Pllumi ka qenë në mes historisë dhe shkrimit të saj e me gjasë ashtu do të mësohemi ta shohim së jashtmi, por studiuesit e veprës së tij janë të ndarë qartë: disa nga letrarësia e të tjerë nga vërtetësia, morali i shkrimit, historia, apo ideologjia siç është rasti i Plasarit, i cili në një tjetër studim të mëvonshëm për Atë Zef Pllumin, ngasja më shumë se nga teksti do e shpjerë nga idetë për ta përkufizuar atë si *ideologun ndërmjet dy shekujve*<sup>12</sup>. Por vazhdojmë t'i rrimë rendit kronologjik.

Në vitin 2001 At Zef Pllumi boton librin “*Françeskanët e Mëdhaj*”, i cili përfaqëson një pjesë të pandarë të “misionit” të tij të nxjerrjes nga harresa të traditës “*ma të shkëlqyeme të popullit shqiptar*”<sup>13</sup>. Vepra tjetër “*Ut*

<sup>9</sup> Vëllimi i tretë i trilogjisë *Rrno vetëm për me tregue*, Botues Hylli i Dritës. Tiranë, 2001.

<sup>10</sup> At Zef Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, Shtëpia botuese “55”. Tiranë, 2006.

<sup>11</sup> I. Kadare, Parathënie: *Rrno vetëm për me tregue*, Shtëpia botuese “55”. Tiranë, 2006. f. 6-7.

<sup>12</sup> A. Plasari, Parathënie: *Kështu foli At Zef Pllumi*, Shtëpia Botuese Onufri. Tiranë, 2008. f. 22.

<sup>13</sup> At Zef Pllumi, *Françeskanët e Mëdhaj*, Botimet Françeskane, Shkodër, 2001. f. 13.

*Heri Dicebamus (sic Thonim dje...)*<sup>14</sup>” botohet në vitin 2002. Ky libër është një përmbledhje shkrimesh publicistike. Në vitin 2004 Atë Zef Pllumi boton një libër të zhanreve të përziera, ku gdhendet historia e bazuar mbi kujtesën (për të cilën duhet pohuar që ishte e një cilësie unike sepse disa dokumente të gjetura nga studiuesi italian Italo Sarro konfirmojnë informacionin e dhënë në libër) të rrëfyer me një stil të veçantë shkrimor. Ky libër titullohet “Fрати i Pashallarve Bushatli”.<sup>15</sup>

Novela “Njerëz fisnikë” botohet po në këtë vit së pari në një të përditshme dhe, në vitin 2006, tek “Histori kurrë e shkrueme”.<sup>16</sup>

Të gjitha këto vepra kanë zgjuar interes të madh dhe bujë mediatike. Në vitin 2006 Juria Kombëtare e çmimeve të letërsisë për të gjitha prurjet e tij në lëmin e memuaristikës e të kulturës sonë kombëtare e, në veçanti, për trilogjinë “Rrno vetëm për me tregue” i akordon çmimin “**Penda e Artë**”. Por studimet dhe kritikën e mirëfillta profesionale për veprën e At Zef Pllumit fillojnë pas vdekjes së tij.

Numri përkujtimor i revistës “Hylli i Dritës”<sup>17</sup>, kushtuar At Zef Pllumit, shënon edhe fillimin e kësaj kritike. Konferencat shkencore “Franceskanët në Letërsinë Shqipe” dhe “At Zef Pllumi mes shkrimit dhe historisë” po të vitit 2008 shënojnë një prirje të kalimit nga gjykime sociologjike e ideologjike në interpretimin e tekstit të veprës së At Zef Pllumit. Ardian Ndreca në punimin e tij “At Zef Pllumi: Ai që dinte me Bashkue në Emën të Shpirtit”<sup>18</sup> vazhdon ta shohë At Zefin si një figurë komplekse me disa misione si dëshmitar i kohës së komunizmit, si shpirt kritik, si veprimtar që kërkon të shkollojë rininë shqiptare në universitetet europiane, si gjurmues i së kaluarës me pozicionin e tij ndaj gjuhës dhe traditës geqe, si instrument rikthimi në traditën e mohuar kombëtare. Gjithashtu Rudolf Marku tek “Jeta nuk ndodh pa ne”, jetën dhe veprën e Zef Pllumit i unifikon i bën një dhe i rrëfen ato në mënyrën e vet duke u shtyrë nga kujtimet personale për të arritur në përfundimin “Të gjithë jemi bashkëmoshatarë me patër Zefin.

<sup>14</sup> At Zef Pllumi, *Ut Heri Dicebamus, Sic thonim dje....* . Botimet franceskane. Shkodër, 2001.

<sup>15</sup> At Zef Pllumi, *Fрати i Pashallarve Bushatli –Erazmo Balneo*. Botimet Franceskane, Shkodër, 2004.

<sup>16</sup> At Zef Pllumi, *Histori kurrë e shkrueme*, Shtëpia Botuese “55”. Tirana, 2006.

<sup>17</sup> “Hylli i Dritës-At Zef Pllumi in memoriam”. Botimet Franceskane. Shkodër, 2008

<sup>18</sup> Ardian Ndreca, “At Zef Pllumi: Ai që dinte me bashkue në Emën të Shpirtit”, në Konferencën shkencore *At Zef Pllumi mes Shkrimit dhe Historisë* Tiranë, shtator 2008.

Historia ka ndodhë krejt pranë nesh, për mos më thanë brenda nesh. Ne nuk mund të themi se jeta ndodhi pa ne...<sup>19</sup>” At Zef Pllumi i shfaqet atij si rrëfyes i historisë (historian) dhe objekt i historisë pa u ndalur tek të rrëfyerit si akt. Tek mënyra e të rrëfyerit, tek teksti do të ndalen edhe Ardian Marashi me kumtesën “Dekalog pëshpëritjesh për At Zef Pllumin”, i cili veprën “Rrno vetëm për me tregue” e konsideron “model i tekstit në veprim, i atij teksti i cili, me një mijë e një fije të padukshme, ndërlidhet aktivisht me problematikën pa fund të shoqërisë e të jetës shqiptare, me historinë, kulturën, etnosin, identitetin, çështjet aktuale, prefigurimin e së ardhmes. Një intertekst dinamik.” i denjë për t’u quajtur prej tij “Libri i librave<sup>20</sup>”.

Jeta e tij si kundërshtar i regjimit hulumtohet nga Kastriot Dervishi tek “Dy dënimet e At Zef Pllumit”<sup>21</sup>. Këtu kemi rastin të shohim se si konsiderohej At Zefi nga gjuha dokumentare e arkivave të Ministrisë së Brendshme, një gjuhë ideologjike. “Dashunia për librin krim kundër Shtetit” e Gjovalin Çunit është një tjetër shkrim, dëshmi e raportit të hershëm rinor të Pllumit me librin, arkivat dhe traditën françeskane. Një dëshmi që gjithashtu sjell një listë shkrimesh dhe veprash të pabotuara të françeskanëve, të sekuestruara në vitin 1946 gjatë arrestimit të parë të tij! Po ashtu Zef Gurakuqi, redaktor i “Hyllit të Dritës”, që kur ajo u rihap nga Pllumi, ka shumë kujtime për të që na ndihmojnë për të plotësuar personalitetin e tij. Gurakuqi shpreh bindjen se At Zefi “Jeton i gjallë në kujtesën e brezave”<sup>22</sup>.

Ai rrëfen aspektin privat të jetës, por edhe atë zonë privatësie të Pllumit në të cilën ai gjykonte për shumë çështje publike nga ku shohim se Pllumi ishte i njëjti në publik të gjerë e po ashtu dhe me bashkëpunëtorët e tij. Elda Omari e sheh At Zefin si *Misionar të kulturës*<sup>23</sup>, pa analizuar në hollësi produktet e tij kulturore por misionin e përmbushur të shkollimit të studentëve shqiptarë në Evropë. Një aspekt interesant zbulon Giovanni Brusegan me kumtesën “Françeskani që bani të njohtun Shqipninë jashtë” nga ku ndajmë përcaktimin: “Tue qenë se regjimi komunist kishte mbytë “mendjet” e disidencës qytetare dhe fetare, ndihej nevoja e “mendjeve” të reja. Prej këtu buronte pasioni i tij për kulturën, shikimi i tij profetik që do

<sup>19</sup>R. Marku, “Jeta nuk ndodh pa ne” po aty *At Zef Pllumi mes shkrimit dhe historisë*.

<sup>20</sup>A. Marashi, “Testamenti kulturor i Françeskanve të Mëdhenj” ... ibidem.

<sup>21</sup>K. Dervishi, “Dy dënimet e At Zef Pllumit”. Revista “*Hylli i Dritës- At Zef Pllumi in memoriam*”. Shkodër, 2008. f. 64.

<sup>22</sup>Z. Gurakuqi, “Jeton i gjallë në kujtesën e brezave” ... ibidem. f. 81.

<sup>23</sup>E. Omari, “At Zef Pllumi-Misionar i Kultures” ... ibidem ..., f. 29.

të ishte pararendës në zgjidhjet dhe në perspektivat e emancipimit<sup>24</sup>”. David Luka me shkrimin “Atë Zef Pllumi- i fundit i Françeskanve të Mëdhenj<sup>25</sup>” jetën e sheh gjithashtu si vepër dhe veprën si jetë duke mbetur midis tekstit dhe veprimit. Luka jep përcaktime të tipit “Atë Zef Pllumi ishte “produkt i pastër i françeskanëve”, “misionar françeskan”, “shkrimtar”, “publicist”, “veprimtar shoqëror”. Arben Ndreca me “Rrno vetëm për me tregue e fratit shqiptar At Zef Pllumi ose lufta për kujtesën kolektive<sup>26</sup>” e sheh Pllumin si shkrimtar dhe si personazh të historisë së tij duke pohuar se “Asht me u çuditë se sa shumë i ngjason At Zefi Ulksit, e kjo jo vetëm për mendjen e mprehtë por edhe si fat njerzor.”

Si kritik e sheh atë Anton Çefa me artikullin “At Zef Pllumi për eposin e kreshnikëve”, duke arritur në përfundimin se “ka shtrua për të ardhmen detyrën e studimeve krahasuese të eposit në rrafshet etike, estetike, juridike, poetike e filozofiko-historike, që të dalin në pah cilësitë etnike të këtij monumenti të çmueshëm të kulturës sonë popullore<sup>27</sup>.”

Një përmasë pak të rrahur zbulon Artan Shkreli me shkrimin “At Zefi-‘Pllumi’ i Monumenteve Veriake<sup>28</sup>”, përkujdesjen dhe kontributin e Padres për gjithçka që përbën trashëgimi kulturore e historike duke nisur me Voskopojën, kishën e motrës së Gjergj Kastriotit në Kep të Rodonit, Kishën e Shirqit të Rubikut etj”. Po ashtu tek “Hylli i Dritës” in memoriam Persida Asllani merr në analizë “Histori kurrë e shkrueme”, të botuar në vitin 2006. Ndryshe nga ç’jemi mësuar deri tani, Asllani në diskursin e saj përqendrohet tek teksti i ndërlyzuar letrar dhe historik duke i dhënë një kahje të re kritikës ndaj veprës së Pllumit “Histori kurrë e shkrueme” “është edhe Historia siç nuk deshën kurrë që të shkruhet. Jo më e ngurtë dhe e vdekur, fakt i shterrur i një kujtesë mekanike, dhe jo më sterile nën narkozë ideologjish. Në dejët e historisë duhet të pulsojë vdekja dhe jeta, teksti dhe

<sup>24</sup> Dom Giovanni Brusegan “Françeskani që e bani të njoftun Shqipninë jashtë”. Në Konferencën shkencore *At Zef Pllumi mes shkrimit dhe historisë*. Tiranë, Shtator, 2008.

<sup>25</sup> D. Luka “At Zef Pllumi –I fundmi i franceskanëve të Medhaj”. *Hylli i Dritës-In memoriam At Zef Pllumi*. Shkodër, 2008, f. 47

<sup>26</sup> A. Ndreca “Rrno vetëm për me tregue e fratit shqiptar At Zef Pllumi ose lufta për kujtesën kolektive”. *Hylli i Dritës-in memoriam*. Shkodër, 2008, f. 35

<sup>27</sup> A. Cefa “At Zef Pllumi per eposin e kreshnikve”. *Hylli i Dritës-in memoriam At Zef Pllumi*. Shkodër, 2008, f. 59

<sup>28</sup> A. Shkreli, “Pllumi i monumenteve veriake”. *Hylli i Dritës-in memoriam At Zef Pllumi*. Shkodër, 2008. f. 54

fjala...dëshmia gjën me At Zef Pllumin përsosjen e saj letrare. Madje ajo është e lexueshme dhe e vërtetueshme plotësisht, vetëm në këtë hapësirë kufijsh të lëvizshëm, ku teksti historik dhe teksti letrar lakmojnë pa pushim njëri –tjetrin<sup>29</sup>”.

Robert Elsie tek “Kujtimi im për At Zef Pllumin” shkruan: “Libri i tij është i thjeshtë, pa pretendime letrare”, por “që trondit më thellë se çdo roman<sup>30</sup>”.

Kemi pasur rastin jo pak herë ta shohim At Zef Pllumin në intervista të ndryshme, në ato televizive e gazetareske, asnjëherë njësoj, gjithmonë i preferuar për gazetarët dhe pikërisht këtë marrëdhënie të veçantë trajton Elsa Demo tek “Pasqyra e të rrefyemit<sup>31</sup>” për të përfunduar që Ati ishte i ndryshmi, personazhi më i veçantë i Shqipërisë postkomuniste.

“Rrno vetëm për me tregue” është përkthyer në USA nga Kate Schank dhe ajo vjen në Tiranë për të sjellë dëshminë e saj për këtë proces jo të lehtë përkthimi për shkak të nuancave të shumta që mbart libri i Pllumit. Me kumtesën “At Zef Pllumi-“Live To Tell<sup>32</sup>” përkthyesja ndalet tek atmosfera psikologjike që ky libër i ka krijuar dhe tek impakti që ai i krijon lexuesit amerikan.

Qasje tjetër ofron Edmon Çali me shkrimin “Zef Pllumi, Shkrimtar Modern Dhe Kritik: 1001 Netët e Letërsisë Shqiptare<sup>33</sup>”.

Që në krye të herës Çali bën dy përcaktime që largohen nga zhargoni që prodhon konteksti, pra, përcaktimi si shkrimtar modern dhe kjo cilësi “rrjedh nga dhuntia e tij letrare dhe nga përgatitja teorike e plotë. Një nga treguesit e modernitetit në shkrimet e tij është prania e fëmijërisë, intertekstualiteti dhe Autobiografia”. Profilin e tij kritik e ndërton duke gjykuar mbi qëndrimin e Pllumit ndaj realizmit socialist dhe shqyrtimin që ai i bën traditës françeskane, analizën ndaj veprës së Fishtës dhe Atë Donat Kurtit, parathënien në veprën e Kasem Trebeshinës etj.

Një përpjekje bën edhe Kolec Çefa për ta kujtuar At Zefin që në të ri si një mënyrë për t’u shprehur edhe për fëmijërinë e tij<sup>34</sup>. Në konferencën e

<sup>29</sup> P. Asllani, “Histori kurrë e shkrueme”, ibidem. f. 96.

<sup>30</sup> R. Elsie, “Kujtimi im për At Zef Pllumin”, ibidem. f. 103.

<sup>31</sup> E. Demo, “Pasqyra e të rrefyemit”, ibidem.

<sup>32</sup> K. Schank, “At Zef Pllumi-Live to tell”. Konferenca *At Zef Pllumi mes shkrimit dhe historisë*. Tiranë, Shtator 2008.

<sup>33</sup> E. Çali, “At Zef Pllumi shkrimtar modern dhe kritik: 1001 netët e letërsisë shqiptare”. *Hylli i Drites –In Memoriam At Zef Pllumi*. Shkodër, 2008, f. 106.

<sup>34</sup> Kolec Çefa, “Tu kujtue pader Zef Pllumin”. Ibidem f. 117.

organizuar nga QSA, Universiteti i Tiranës, Provinca Françeskane dhe *Instituti Alcide De Gasperi* një vit pas vdekjes, shohim të konturohet më qartë mendimi kritik me objekt tekstin dhe letrarësinë e tij duke pranuar se kemi të bëjmë me një produkt që rri mes letërsisë dhe historisë një përzierje zhanresh.

Kështu studiuesja dhe përkthyesja e Veprës së At Zef Pllumit në Francë, Odile Daniel, në kumtesën “Mishërimi i vlerave tradicionale të shqiptarëve”, luan ndërmjet personalitetit, tekstit dhe historisë. Ajo shkruan se “... në personalitetin e tij u mishëruan gjithë kujtesa e Shqipërisë dhe të gjitha vlerat që bënë madhështinë e këtij vendi” për të vazhduar me ... “një vepër rehabilitimi të historisë shqiptare” dhe duke përfunduar se në veprën e At Zef Pllumit “Gjuha shqipe duket në bukuritë e veta fillestare.”<sup>35</sup>

Studiuesi i mirënjohur Sabri Hamiti, në kumtesën *Misionari i rebeluar* hap shtigje të reja interpretimi, bën një analizë të mirëfilltë teorike, ku shpjegon marrëdhënien e shkrimtarit me lexuesin duke interpretuar edhe vetë titullin e trilogjisë “Rrno vetëm për me tregue”. Sipas interpretimit të tij “Trajta e titullit është një frazë në mënyrën urdhërore, që nënkupton dy veta (Unë dhe Ti) të cilët e ndërrojnë pozicionin për të ndërtuar marrveshjen, pajtimin. Libri, Liria e Robnia sugjerojnë e tregojnë që libri shkruhet për lirinë e robërinë jo më si koncepte universale por si shënja konkrete, madje personale<sup>36</sup>”. Hamiti nuk e vë aspak në dyshim letrarësinë tek dëshmia e tij të cilën e sheh të realizuar në tre shkallë “1. Jetesa dhe mbijetesa e ferrit 2. Përjetimi dhe rijetimi si kujtesë 3. Zija e shkrimit që mbështetet në mbijetesë e në rikujtim për të dhënë dëshminë në trajtën e besueshme, bashkë me efektin e reales<sup>37</sup>”. Ai gjen një diskurs me disa nivele në tekstin e Pllumit “duke diferencuar kohën e ndodhjes nga koha e shkrimit madje më shenja tekstore kalon në kohen e përjetshme për të artikuluar të vërteta universale<sup>38</sup>”. Dy karakterizime referuese të Hamitit duhen nënvizuar posaçërisht. Pllumi në to shihet në krye të procesit kulturor në Shqipërinë e pas viteve 90.: 1. “Kjo është një kryevepër e llojit në letërsinë shqipe dhe një vepër me rëndësi të përbotshme në fushën e logorografisë 2. At Zef Pllumi kthehet në letërsinë shqipe për të dëshmuar gegnishten në një vepër

<sup>35</sup>Odile Daniel, “Misherimi i vlerave tradicionale të shqiptarve”. Në Konferencën shkencore *At Zef Pllumi mes shkrimit dhe historisë*. Tiranë, Shtator 2008.

<sup>36</sup>S. Hamiti, “At Zef Pllumi –Misionari i Rebeluar”, ibidem.

<sup>37</sup>S. Hamiti: po aty.

<sup>38</sup>Po aty.

të madhe për t'u shfaqur si gega i fundit jo vetëm në kuptimin shkrimor<sup>39</sup>. Gjithashtu Hamiti tek libri **Albanizma** përpos **Misionarit të rebeluar** shfaqet edhe me dy studime të tjera që shënojnë kulmin e mendimit kritik për veprën e At Zef Pllumit. Në studimin “At Zef Pllumi: Françeskanët e mëdhenj” Hamiti shprehet se “Vepra e tij është një dëshmi (dokument) dhe vlerësim (monument), dhe, në fillim e në fund, një vepër autobiografike, si të gjitha veprat e tij, duke dëshmuar përfundimisht që nuk është vetëm një shkruar (skriptor) por edhe krijues (autor) i letërsisë shqipe<sup>40</sup>”. Fundi ose fillimi siç e quan Hamiti veprën postume “Saga e fëmijnisë” të Pllumit shfaq “dy pika përcaktuese të jetës së njeriut të cilat nuk mund t'i shkruajë asnjëherë: lindjen dhe vdekjen... kështu ego-ja padashur kthehet në alter ego në shkrim, uni bëhet një ai, apo së paku në unë tjetër...duke krijuar domosdoshmërisht një biografemë dhe një ideolemë<sup>41</sup>”. Në fund të punimit të tij të tretë Hamiti arrin në përfundimin se “Në vështrimin e modelit krijues Zef Pllumi është shkrimtar dokumentar, kurorëzues i prozës dokumentare<sup>42</sup>.”

Nga këndvështrimi gjuhësor i qaset “Sagës së fëmijnisë” Ledi Shkreli në parathënien e këtij libri, e cila vëren se “... në këtë vepër haset një shqipe pak më ndryshe nga ajo që lexuesi ka shijuar tek fjala vjen tek “Rrno vetëm për me tregue”. Sintaksa paraqitet po ajo, por në linearitetin e saj mbërthen natyrshëm e me vetëdije mjete kumtuese që burojnë prej një trualli specifik me jeh historik, i cili sot ka filluar të meket prej braktisjes masive të maleve nga banorët e lashtë të tyre... Përditshmëria e jetës së maleve kërkon ligjërimin e vet dhe padër Zefi len t'i burojë vetiu ky arketip gjuhësor. Mirëpo fjalët nuk janë vetëm përmbajtje, ato janë edhe formë<sup>43</sup>”.

Françeskani At Gazmend Tinaj në kumtesën “Të humbësh për të fituar” synon të theksojë me forcë pandashmërinë e veprës së Pllumit nga feja, ndoshta i shtyrë nga disa këndvështrime laike të studiuesve të ndryshëm. Tinaj shprehet se “At Zefi përqafoi kryqin dhe të kryqëzuarin, prandaj është sot ai që njohim. At Zefi nuk mund të ndahet nga Kryqi, nuk mund të

<sup>39</sup>Po aty.

<sup>40</sup>S. Hamiti, *Albanizma*. Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Prishtinë, 2009, f. 185-198

<sup>41</sup>Ibidem.

<sup>42</sup>Ibidem.

<sup>43</sup> L. Shamku Shkreli, *Parathënie “Saga e Fminisë”*, Botimet Françeskane, Shkodër, 2009. f. 15

ndahet nga Krishti, nuk mund të ndahet nga Kisha, nuk mund të ndahet nga populli<sup>44</sup>”.

Ardian Ndreca tek “Historia si premtim ndaj së vërtetës ” veprën e Pllumit e sheh sërish në një kontekst filozofik duke u shprehur se: “Tek At Zef Pllumi shkrimi i historisë nuk ka qenë një mënyrë me u skapullue prej së kaluemes. Ka qenë rruga për me çlirue shqiptarët prej peshës së padukshme të së kaluemes që jeton ende midis nesh dhe ndikon negativisht në jetën tonë.”

Dhurata Shehri, një nga adhurueset e veprës së Pllumit dhe skeptike në të njëjtën kohë për fatin e shkollës që e nxori, duke e përcaktuar fratin tonë si të fundit nxënës të madh të saj, pohon se “Veprën e tij e sheh si një antidot ndaj harresës dhe fuqi morale për memorien e kombit. Nëse pararendësit e tij të mëdhenj ia dolën të ruajnë kujtesën e kombit, Padër Zefi duhet të mbronte kombin nga harresa për të vazhduar me konstatimin se “Gegnishtja letrare rimerr statusin e një gjuhe letërsie që vazhdon të shkruhet, që nuk është veç pjesë e historisë por që historinë e dëshmon e krijon”.<sup>45</sup>

Edhe Rudolf Marku tek “At Zef Pllumi mes dijes, evidencës dhe gjuhës”, ndër të tjera konfirmon Pllumin edhe si historian duke gjykuar se “Përparësia e At Zef Pllumit si Historian asht dija e thellë e Historisë së Shqipnisë, një dije e përfueme dhe e stërvitun në arkivat françeskane, nga leximi i dorëshkrimeve të ruajtuna, nga bisedat dhe nga njohja me disa personazhe ma të rëndësishëm të historisë e të kulturës së Kombit tonë, por edhe nga një përvojë vetjake e jashtëzakonshme<sup>46</sup>”.

Mark Marku tek “Etika e Shkrimit të At Zef Pllumit” e sheh veprën e tij si një autoritet moral të padiskutueshëm duke bërë disa përcaktime të goditura: 1. “Rrno vetëm për me tregue e denoncon krimin komunist ashtu siç ka ndodhur dhe ky është akti i parë moral i autorit; 2. Libri i tij është një libër jokomunist për krimet komuniste; 3. Kjo vepër është vepra e parë, ose modeli i parë i veprës së shkruar në Shqipëri pas gati 50 vjetësh, që është e kundërta e modelit të veprës së realizmit socialist; 4. Ajo (vepra) është një dëshmi se morali i shkrimit ekziston ende në shkretëtirën morale të quajtur Shqipëri që ka lënë pas komunizmi<sup>47</sup>”.

<sup>44</sup> At Gazmend Tinaj, “Të humbesh për të fituar”. Në Konferencën shkencore. *At Zef Pllumi-mes Shkrimit dhe historisë*. Tiranë, Shtator 2008.

<sup>45</sup> Dh. Shehri, “At Zef Pllumi i Fundmi i shkolles Françeskane”. Në Konferencën shkencore *At Zef Pllumi mes Shkrimit dhe Historisë*. Tiranë, Shtator 2008.

<sup>46</sup> R. Marku, “At Zef Pllumi mes dijes, evidencës dhe gjuhës”, po aty.

<sup>47</sup> M. Marku, “Morali i Shkrimit”, po aty.

Agron Tufa dekodifikon veprën e Atë Zef Pllumit nëpërmjet “Rrno (jo) vetëm për me tregue<sup>48</sup>” në rrafsh krahasimor me të tjera vepra të ngjashme në letërsinë botërore dhe si kjo reflektohet moralisht tek shoqëria lexuese shqiptare duke këshilluar “Lexojeni të paktën për vlerat e një rrëfimi të kulluar e brilant, për gjuhën aq tërheqëse e të padhunë, për zinxhirët të tërë kompozicionalë të realizuar si vepra letrare tejet intriguese.”

Tufa akoma ka diçka për të thënë mbi këtë vepër dhe për këtë bën një “Përshpirtje për traditën letrare françeskane” ku tradita gege dhe gegnishtja pas “delegjitimitit” legjitimohen sepse “Dhunia plastike e memuaristikës nën pendën e At Zef Pllumit, dëshmitë e saj të paçmuara falë së cilës ne mund të dëgjojmë e të shohim të vetmin pasues të Fishtës dhe asaj “atlantide” kulturore të françeskaneve, ishte, me sa duket, një postscriptum, i vetmi postscriptum i denjë i homazhit, por një postscriptum madhështor i asaj tradite letrare, e cila në disa raste vendimtare i dha profilin dhe fizionominë autentike gjithë letërsisë shqipe.”<sup>49</sup>

Në artikullin e të tij përmbledhës “Letrarësia dhe vërtetësia në Letërsinë dëshmuese”<sup>50</sup>, studiuesi Shaban Sinani duke përshkruar panoramën e letërsisë dëshmuese shqiptare vë re se “... në të gjitha kohërat letërsia dhe historia kanë pasur një kushtëzim të ndërsjelltë. Gjatë dy dekadave të fundit ky kushtëzim është shfaqur në dy forma kryesore: si qëndrim i letërsisë ndaj historisë dhe si plotësim, interpretim shpjegim i saj” në këtë kontekst citon edhe veprën “Rrno vetëm për me tregue” të Pllumit.

Tash së voni Aurel Plasari rikthehet përsëri me një parathënie të gjatë “Me bashkëbiseduesin në mes tonë” tek libri “Kështu foli At Zef Pllumi”, duke u shfaqur thellësisht kërkuesor edhe pas kaq vitesh për veprën dhe fjalën e Atë Zef Pllumit e mbi të gjitha për idenë e tij të lirisë.

“Këta “njerëz të mëdhenj”, simbas tij, i dërgon një populli Zoti. (Këtu nuk ka nevojë për sqarim që ai besonte në Zot). Nëse atë vetë, Fratin e ideologjisë së dashurisë përkundrejt dhunës dhe të lirisë përkundrejt tiranisë, e pati sjellë po Zoti, mund të ngurrojmë të themi. Por, edhe pa qënë klerikë, nuk mund të mos pranojmë se do na bëhet “dhanti” një tjetër i tillë.”<sup>51</sup>

<sup>48</sup> A. Tufa, “Rrno (jo) vetëm për me tregue”, po aty.

<sup>49</sup> A. Tufa, “Përshpirtje për traditën letrare françeskane”. Në Konferencën shkencore *Françeskanët në Letërsinë Shqipe*, Tiranë, Dhjetor 2009.

<sup>50</sup> Sh. Sinani, “Letrarësia dhe vërtetësia në Letërsinë dëshmuese”, në *Gazeta shqiptare* f. 12.

<sup>51</sup> A. Plasari, *Parathënie, “Kështu Foli At Zef Pllumi”*. Shtëpia botuese Onufri, Tiranë, 2008, f. 22.

Nga ky vështrim panoramik për etapat e mendimit kritik mbi veprën e At Zef Pllumit mund të arrijmë në përfundimin se tashmë vepra, mendimi dhe ideologjia e tij janë lëndë studimore e rëndësishme për kritikët dhe albanologët shqiptarë, të cilët bashkohen në mendimin se Pllumi është fenomeni kulturor më i spikatur i njëzet viteve liri. Studiuesit e ndryshëm i qasen në tre këndvështrime veprës së tij, në planin kontekstual, tekstual dhe gjuhësor duke u bashkuar në idenë se vepra e tij kryesore “Rrno vetëm për me tregue” është një kryevepër e letërsisë memuaristike shqiptare dhe asaj botërore. Besueshmëria, sinqeriteti dhe të shkruarit pa mllef janë shenja dalluese të rrëfimit të Pllumit, çka e bëjnë letërsinë e tij një antimodel të realizmit socialist. Nga konteksti At Zef Pllumi shfaqet si ideolog i lirisë kundër tiranisë, nga teksti një mjeshtër i rrëfimit dhe i stilit, shkrimtar modern i shkollës françeskane, nga gjuha dëshmohej si “Gega i fundit”, autor i një letërsie të madhe në gegnisht duke risjellë vëmendjen mbi pasurinë e pashtershme të këtij dialekti dhe aftësinë e tij për të dhënë vepra të mëdha.

